

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *arsimi muzikor* për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën mësimore arsimit muzikor për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar bazohet në qëllimet /rezultatet e parapara me programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet rregullisht në bazë të planit mësimor të caktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema të caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë mësimore, megjithatë duhet të ruhet fondi javor i orëve të parapara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndë mësimore me 1 orë në javë parashikohen 32 orë mësimore në programin e shkurtuar në kohëzgjatje prej 30 minuta.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të përcaktuara në programin mësimor të rregullt.

2. Pasqyra e temave dhe përmbajtjet mësimore

Tema/Fusha

1. AKTIVITETE INTERPRETIMI (këndimi, ekzekutimi në instrumentet muzikore për fëmijë, të shprehurit muzikor dhe krijimtaria)

6 orë

1 - Përpunimi i këngëve për fëmijë, artistike, popullore me ambitus a e vogël - e2 me dëgjim dhe me zbatimin e tekstit notal.

2 - Performancë e ushtrimeve të tërësive të ndryshme muzikore në F-dur dhe d- moll me zbatimin e vlerave notale, në taktet 5/8, 7/8 dhe 9/8 të masës së thjeshtë (kryesisht sinkopë) dhe masës së përbërë;

3- Shprehjet muzikore të nxënësve përmes elementeve të mësuara nga shkrimleximi muzikor

Tema/ Fusha

2. DËGJIMI I MUZIKËS 16 orë

Njësitë mësimore

1 – Njohja me veprat muzikore – skenike, operë; operetë; balet; mjuzikël;

2 – Përpunimi përmbajtësor i operetës nga kompozitorë të huaj: „Aida“ - XH. Verdi;

3 – Përpunimi përmbajtësor i operës nga kompozitorë të vendit: „Despina dhe Mister Doks“ - D. Buzharovski;

4 – Përpunimi përmbajtësor i operetës: „Lakuriqi“ - J. Shtraus;

5 – Përpunimi përmbajtësor i baletit nga kompozitorë të huaj: „Liqeni i mjellmave“ – P. I. Çajkovski;

6 – Përpunimi përmbajtësor i baletit nga kompozitorët e vendit „Labin dhe Dojrana“ nga baleti „Labin dhe Dojrana“ – T. Prokopiev;

7 – Mjuzikëll;

8 – Muzikë filmike nga autorët e huaj dhe të vendit;

9 – Njohja me zhanret xhaz dhe bluz;

10 – Njohja me zhanret RnB, hip-hop dhe rap;

11 – Njohja me zhanret Rock and roll dhe POP;

Tema/Fusha

3. SHKRIMLEXIMI MUZIKOR 6 orë

Njësitë mësimore

1 - Shkalla F-dur me elementet e saja (emrat e toneve – solmizimi dhe alfabeti muzikor, gradë, shkallë, - e plotë dhe gjysmëshkallë, parashenja b, tetrakordi);

2 - Shkalla d-moll lloji natyror, lloji harmonik dhe melodik me elementet e veta (emrat e toneve- solmizimi dhe alfabeti muzikor, gradë, gjysmëgradë, parashenja bemol b, tetrakordi);

3 - Bemol;

4 - Sinkopë;

5 - Takti 9/8 i masës së përbërë.

Tema/Fusha

4. KRIJIMTARIA MUZIKORE POPULLORE – Traditat dhe zakonet 4 orë

Njësitë mësimore

1- Tradita dhe doket e popullit tonë dhe të popujve të cilët jetojnë në vendin tonë;

2- Cikli i dasmës;

3- Veshjet popullore;

4- Muzika popullore në zhanret e ndryshme bashkëkohore;

3 Rekomandimet didaktike

Përmbajtjet muzikore për arsimin muzikor në klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar mundësojnë integrimin e brendshëm dhe të jashtëm që nënkupton planifikimin e integruar ndërmjet temave mësimore në kuadër të programit për arsimin muzikor, si dhe planifikimin e jashtëm dhe integrimin me lëndët tjera mësimore. Programi mësimor i shkurtuar për lëndën mësimore arsimit muzikor për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar do të realizohet për 159 ditë në vitin shkollor 2020/2021 në 32 orë mësimore me kohëzgjatje prej 30 minuta. Përmbajtjet mësimore të programit mbeten të njëjta por të radhitura në kuadër të 32 orëve mësimore, ku edhe është bërë shkurtimi prej 4 orë. Në këtë program numri i orëve është dhënë në mënyrë orientuese, me çka i lihet hapësirë mësimdhënësit që të shprehë kreativitetin e vet dhe nevojën në përputhje të kushteve materiale-teknike dhe hapësinore, aktiviteve të ndryshme dhe përshtatja e mësimimit me gjendjen e jashtëzakonshme në korniza botërore të shkaktuara nga virusi Kovid -19. Për realizimin e tërësishëm të përmbajtjeve mësimore nga temat mësimore, në këtë program është paraparë shkurtimi nga 4 orë të bëhet në temën e parë mësimore „Aktivitete interpretimi” e cila ngërthen këndimin, ekzekutimin në instrumentet muzikore për fëmijë, shprehjet muzikore dhe krijimtaria. Përmbajtjet në këtë temë janë integruar nga brendia mes veti, me çka mundësohet shumë më lehtë performimi dhe realizimi i përmbajtjeve mësimore të parashikuara në numër më të vogël të orëve të parapara. Kjo temë përmban katër përmbajtje mësimore me realizimin e paraparë prej 10 (dhjetë) orë mësimore në programin e rregullt, ku tani për përmbajtjet e njëjta në programin e shkurtuar parashihet realizimi prej 6 (gjashtë) orë mësimore. Njëkohësisht, i lihet mundësia mësimdhënësit, jo vetëm në temën e paraparë dhe përmbajtjet të mund të bëjë shkurtimin – përkatësisht integrimin, por edhe në temat dhe përmbajtjet tjera në përputhje me kreativitetin dhe nevojat e tij.

Në përpilimin e planifikimit për realizimin e programeve mësimore për lëndën arsimit muzikor nuk është paraparë qasja e unifikuar të mësimdhënësit. Nevojitet që secili mësimdhënës individualisht të bëjë ndërlidhjen e përmbajtjeve mësimore të temave të ngjashme dhe të ndryshme kundrejt nevojave reale për realizimin e mësimimit, njëkohësisht duke pasur parasysh lidhshmërinë logjike ndërmjet tyre. Rekomandohet mësimdhënësi gjatë

realizimit të orës mësimore në të cilën ka të integruar dy ose më shumë përmbajtje mësimore të ketë kujdes në vëllimin e materies mësimore. Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e caktuara në programin mësimor të rregullt, njëkohësisht duke marrë parasysh kohëzgjatjen e orës mësimore prej 30 minuta. Ndjekjen e të arriturave të nxënësve secili mësimdhënës individualisht duhet ta integrojë në kuadër të orëve të prashikuara për realizim duke përdorë metodat, teknikat dhe instrumentet e ndryshme.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në bazë të normativit për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *arsimi muzikor* për klasën IX (e nëntë) në arsimin fillor nëntëvjeçar e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
